



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.06.2018, ora 10:30

Drejtton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për pagesën e detyrimeve të prapambetura në favor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)” .
3. Projektligji për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.4.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.3.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.2.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit””, të ndryshuar” .

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Ismet Beqiraj, Përparim Spahiu dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Reme Lala, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi dhe Nadire Meçorapaj.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Irena Rista – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Duçka – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Ju kërkoj ndjesë për vonesën, por pati mbivendosje të mbledhjeve.

Në rendin e ditës së punës së këtij komisioni kemi dy çështje për diskutim.

Së pari, projektligji “Për pagesën e detyrimeve të prapambetura në favor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”.

Së dyti, projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 7918, datë 13. 4. 1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr. 1030, datë 23. 02. 1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)” dhe dekretit nr. 1049, datë 27. 03. 1995 “Për disa plotësime në dekretin nr. 1030, datë 23. 02. 1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit””, të ndryshuar”.

Për të prezantuar projektligjin ka ardhur në Komisionin e Ekonomisë zoti Erion Luçi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë. Relator i komisionit për të dy projektligjet është zoti Ervin Bushati.

Fillojmë me projektligjin “Për pagesën e detyrimeve të prapambetura në favor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Fjala është për ju, zoti Luçi.

Erion Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, ky është një propozim relativisht bazik. Bëhet fjalë për dy pagesa të prapambetura, një e vitit 1991 për kapitalin bazë dhe një e vitit 1996 për rritjen e kapitalit, për të cilat është marrë angazhim nga Shqipëria për t’u shlyer. Duke qenë se ka kaluar një kohë e gjatë menduam ta sillnim edhe në parlament, pavarësisht se unë do të doja ta paguanim pa qenë nevoja t’ju shqetësonim ju. Pagesa e kapitalit për anëtarësinë tonë të plotë në BERZH është rutinë.

Nëse keni nevojë për ndonjë detaj, jemi të hapur.

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Luçi!

Fjalën e ka zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit, kryetar!

Vendi ynë është anëtarësuar me të drejta të plota në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim në vitin 1991 dhe zotëron 3001 aksione me vlerë rreth 30 milionë dollarë.

Sipas marrëveshjes me BERZH-in, çdo vend anëtar duhet të pranojë kushtet dhe afatet e rezolutave që do të adaptohen nga këshillat respektive të guvernatorëve. Në rezolutën nr. 15 të anëtarësimit të Shqipërisë në vitin 1991 dhe rezolutën nr. 59, rritja e parë e kapitalit në vitin 1996, është përcaktuar që shteti shqiptar duhet të paguaj për nënshkrimin e kapitalit fillestar një vlerë prej rreth 1,3 milionë dollarë amerikanë. Kjo vlerë u përket aksioneve të nënshkruara nga shteti shqiptar në vitet '91-'98.

BERZH-i ka kërkuar në vitet 1995-2006 kryerjen e kësaj pagese, por ende nuk është kryer. Në rast se pagesa nuk do të shlyhet, do të ulet niveli i fuqisë së votimit të shtetit shqiptar pranë BERZH-it nga 0,10%- 0,08%.

Projektligji parashikon miratimin për kryerjen e pagesës së prapambetur për 490 aksione të nënshkruara nga qeveria shqiptare si kapital fillestar pranë BERZH-it në vitet '91-'98. Vlera e kësaj pagese është 1,3 milionë dollarë amerikanë dhe do të paguhet nga buxheti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me dy këste: 50% do të paguhet në vitin 2018 dhe 50% në vitin 2019. Kjo pagesë është e parashikuar në PBA-në e viteve 2018-2020.

BERZH-i ka financuar ndër vite vendin tonë me një portofol kredish me vlerë totale 650 milionë euro, si dhe grante me vlerë 55 milionë euro. Mbështetur në këto argumente, i propozoj komisionit miratimin e projektligjit.

Faleminderit!

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Bushati!

Ka pyetje?

Fjalën e ka zoti Pëllumbi dhe më pas zonja Kushi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, kryetar! Faleminderit edhe ju për shpjegimet që dhatë!

Unë e kuptoj detyrimin e shtetit shqiptar për të paguar këtë gjë, është krejtësisht normale, por nuk arrij të kuptoj dot pse nuk është paguar deri më sot. Ka ndonjë arsye pse vjen kaq vonë kjo gjë, edhe pse është nënshkruar që në vitin 1991?

Erion Luçi – Është thjesht neglizhencë e të dyja palëve. Nuk ka pasur presion nga institucionet ndërkombëtare për ta shlyer dhe në këtë mënyrë është shtyrë në kohë. Në këtë moment është bërë presion për ta paguar.

Erion Braçe – Përgjigjja është neglizhencë e të dyja palëve, e tyre dhe jona.

Erion Luçi – Deri diku, po.

Erion Braçe - Neglizhencën tonë e kuptoj, kurse të tyren, jo.

Erion Luçi – Në qasjen që kapitali është i mjaftueshëm për të mbajtur **3A-n**, që e kanë ata, kjo ka ndodhur në shumë organizata. Presioni për rritjen e kapitalit ka ardhur pas krizës globale, ndaj në këtë moment filluan të kërkojnë mbledhjen e detyrimeve.

Kemi pasur disa raste të tilla kur shumica e institucioneve kanë kërkuar plotësimin e kapitalit, sepse janë nën presionin e agjencive të recreating.

Evis Kushi – Edhe unë këtë pyetje kisha.

Së dytë, a është e përballueshme të shlyhet ky detyrim vetëm me dy këste?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime lidhur me këtë projektligj? Nuk ka.

Kalojmë në votim.

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për pagesën e detyrimeve të prapambetura në favor të Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nën për nën.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.06.2018, ora 10:30

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit””, të ndryshuar” .

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Ervin Bushati, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Arben Pëllumbi, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Përparim Spahiu, Ismet Beqiraj (deputet zëvendësues) dhe Edmond Haxhinasto.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Reme Lala, Fatbardha Kadiu, Dashamir Shehi dhe Nadire Meçorapaj.

Të ftuar:

Erjon Luçi – Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Irena Rista – Përgjegjëse Sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Duçka – Drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Erion Braçe – Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit të dytë.

Zoti Zëvendësministër, do ta prezantoni ju edhe projektligjin e dytë?

Erjon Luçi – Po.

Erion Braçe – Urdhëroni, atëherë!

Fjalën e ka zëvendësministri për prezantimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.04.1995 “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.03.1995 “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.02.1995 “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit””, të ndryshuar” .

Urdhëroni, fjala është për ju!

Erjon Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe ky projektligj është bërë tani rutinë në aspektin e zgjatjes që kërkohet, pasi është e disata zgjatje e kërkuar, ku më e fundit ishte para dy vjetësh. Në fund të këtij viti edhe bonot e privatizimit skadojnë sërish në aspektin e vlefshmërisë së tyre, por duke pasur parasysh përdorimin që mund të vazhdojë, sidomos për lehtësimin e kompensimit të ish-pronarëve për truall, nëpërmjet ALUIZNI-it, kemi propozuar të shtyhet edhe me një vit tjetër, për t’i dhënë mundësi përdorimit të këtyre në procesin e kompensimit të pronave dhe të pasurive. Domethënë, është e njëjta arsye që ne e kemi kërkuar herën e kaluar apo edhe herët e mëparshme në aspektin e zgjatjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Faleminderit!

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në vitin 1995 Këshilli i Ministrave filloi emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit, si pjesë e programit të privatizimit masiv. Në këtë proces zotëruesit e bonove të privatizimit blenë aksione të kompanive shtetërore, në këmbim të bonove të privatizimit që ata zotëronin. Në procesin e privatizimit u përdorën edhe lekët e privatizimit të ish-të përndjekurve politikë.

Janë bërë disa shtesa në ligje, sepse, sipas ligjit ekzistues, afati i shpërdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit ka skaduar më 31.12.2017. Nëpërmjet këtij projektligji synohet shtyrja nga data 31.12.2017 në datën 31.12.2020 e afatit të përdorimit të bonove dhe lekëve të privatizimit.

Qëllimi i kësaj mase është krijimi i mundësive të personave që zotërojnë bono dhe lekë privatizimi, që t'i përdorin ato edhe për tre vjet të tjerë, pra deri në fund të vitit 2020. Mundësitë për përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit janë në këto drejtime.

Së pari, një numër i konsiderueshëm i objekteve që administrohen nga Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, organet e pushtetit vendor e të tjerë nuk janë privatizuar ende. Punonjësit e shoqërive aksionare mund t'i përdorin bonot dhe lekët e privatizimit për blerjen e aksioneve të këtyre shoqërive.

Së dyti, një numër i konsiderueshëm objektesh ose banesash janë në procesin e legalizimit nëpërmjet ALUIZNI-it. Bonot dhe lekët e privatizimit mund të përdoren edhe në këtë proces.

Duke qenë se ekziston tregu për përdorimin e bonove dhe lekëve të privatizimit, është e nevojshme të shtyhet afati i përdorimit të tyre për t'u dhënë lehtësi zotëruesve të tyre që t'i përdorin në këtë bono.

Sipas relacionit të projektligjit, gjatë tre vjetëve të fundit janë arkëtuar rreth 705 milionë lekë bono privatizimi. Këto bono janë arkëtuar në procesin e privatizimit të pronës shtetërore nga ish-pronarët e truallit, të cilët kanë të drejtën e parablerjes, si dhe nga subjektet me kontratë emfiteoze apo qiraje.

Mbështetur në këto argumente, i propozoj komisionit miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Erion Braçe – Është e mjaftueshme kjo kohë, zoti Zëvendësministër, apo pas dy vjetësh do të bëjmë të njëjtën gjë?

Erjon Luçi – Kam frikën se do të kërkohet përsëri një shtesë, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Atëherë, vëmë një datë tjetër.

Erjon Luçi – Jo, prandaj kemi vënë dy vjet, sepse e diskutuam edhe herën e kaluar zgjatjen e kohës dhe vlefshmëria është deri në fund të këtij viti.

Megjithatë, një tjetër kohë dyvjeçare është e mjaftueshme për të vazhduar lehtësimin e procesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Urdhëroni, zonja Kushi!

Evis Kushi – Çfarë do të bëhet ndaj këtyre viteve? Do të vazhdohet...?

(Deputetja Kushi flet pa mikrofon.)

Erjon Luçi – Një vit ka kaluar.

Evis Kushi – Si do të ndiqet ky proces?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erjon Luçi – Përfshirja në procesin e legalizimit, domethënë për përdorimin e tyre, është një nga format që është ndjekur, që është arsyeja kryesore pse është lënë aktive...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Dakord lidhur me përfshirjen në procesin e legalizimit. A mund të dimë se sa efektive ka qenë kjo në procesin e legalizimit? Një pjesë e madhe e njerëzve nuk e dinë fare këtë gjë. Po jua them unë.

Erjon Luçi – E qartë.

Erion Braçe – Dakord. Po ju japim, po të doni, 2-3-4 vjet, por problemi është se sa kjo politikë mbërrin te njerëzit, me qëllim që ata t'i përdorin këto letra me vlerë që kanë për të përfituar për pagesën e legalizimit.

Më vjen keq, zoti Bushati!

Sa për pronat e ministrisë, që përmendni, duke renditur aty edhe Ministrinë e Bujqësisë, ato prona janë bërë dyst me tokën. Janë nëpër regjistra, por nuk ekzistojnë. Po jua them unë, që jam deputet i një zone rurale, që ato prona nuk ekzistojnë fare. Mbi to janë bërë ndërtime të tjera, kryesisht shtëpi banimi, të cilat kanë procesin e legalizimit për shkak të gjendjes së pronësisë në këta regjistra. Atje figuron stallë lopësh, ndërkohë që jo vetëm që nuk ka fare stallë lopësh, por aty janë ngritur shtëpi ku banojnë njerëz, të cilat duhet të legalizohen.

Urdhëroni, zoti Angjeli!

Anastas Angjeli – Kjo histori ka 23 vjet që përsëritet, shtyhet, zgjerohet objekti i përdorimit të letrave të privatizimit (bonove). Meqenëse ne jemi sot për të njëjtën histori, them ta bëjmë 3 vjet, afërsisht deri në fund të mandatit të kësaj qeverie.

E dyta, Ministria e Financës dhe e Ekonomisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të bëjnë një program masash, ku do të parashikojnë se si do ta përcjellin këtë vendim tek institucionet dhe te qytetarët, që përfitojnë nga kjo. Kjo ka nevojë për një marrëdhënie me publikun, ka nevojë për një nxitje në mënyrë që vetë institucioni kompetent, që merret me këtë punë (në rastin e legalizimeve), të familjarizohet me këtë çështje dhe të familjarizojë edhe të interesuarit për këtë çështje. Pra, nuk mjafton që të bëjmë një dekret, apo një projektligj, që të lajmërojmë sot datën që do ta japin këta, që janë këtu dhe të mbarojë kjo histori.

Sa për qind e njerëzve, që kanë lidhje me çështjen, e shohin këtë njoftim në medie? 1%, sepse janë të lodhur nga daljet tona në medie. Atëherë, si do të mbërrijë kjo tek ata? Në

sportelet, atje ku venë qytetarët, me mjetet propagandistike me fletushka, me spote, me komunikim me ALUIZNI-n. Pra, duhet gjetur një mënyrë, se u bë kaq kohë dhe është mirë të gjendjet një zgjidhje.

Erion Braçe – Të paktën në 2-vjeçarin e fundit nuk kam dëgjuar nga ALUIZN, që t'u thotë njerëzve se një pjesë të pagesës mund ta bëjnë në atë formë, bile ai nuk e pranon, sepse është shumë më i interesuar të arkëtojë para.

Urdhëroni zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Unë do t'i bëj një pyetje zëvendësministrit. A ka efekt negativ që të jetë pa afat vlefshmëria e bonove të privatizimit? Në Shqipëri edhe sikur një euro apo një dollar pronë të ketë, po kaloi nëpërmjet procesit të privatizimit (ka edhe shoqëri publike, ekzistojnë, sidomos prona publike dhe shtetërore), ne nuk kemi pse e kufizojmë.

Erjon Luçi – Normalisht, kjo shkon edhe kundër asaj që diskutuam, sepse po të vendosësh një limit, krijon edhe një farë presioni që të përdoren.

E dyta, procesi i privatizimit ka një fillim dhe ka një fund sot. Ai nuk mund të jetë një proces i hapur. Domethënë në përgjithësi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo ishte për privatizimin masiv, nuk ishte për çdo lloj prone.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam një pyetje: a keni ju një informacion për gjendjen e bonove të privatizimit që janë në administrim të qytetarëve apo pikave, të cilat mund t'i kenë grumbulluar këto agjenci të ndryshme?

Erjon Luçi – Po ia jap fjalën drejtorit që merret me këtë çështje.

Endrit Duçka – Ne nuk kemi një informacion për sasinë e bonove të privatizimit sot në treg. Kjo është një lehtësi që ne po u bëjmë ish-pronarëve të truallit, që ata të ushtrojnë të drejtën e parablerjes, duke ulur faturën e kompensimit financiar që shteti shqiptar bën për këta ish-pronarë.

Anastas Angjeli – Më falni!

Ju nuk mund të thoni që s'keni informacion, se ju e dini sa janë përdorur, sa janë emetuar dhe diferenca është në duart e qytetarëve. Është në treg në shitje, a është në valixhe apo shtëpi, kjo është çështje tjetër.

Erjon Luçi - Është e saktë, sepse ka një përafërsi.

Anastas Angjeli - Patjetër që ka, sepse i keni përdorur dhe janë grumbulluar. Ka një evidencë në qoftë se nuk ka një libër në Shqipëri, se sa janë grumbulluar dhe sa janë emetuar që në fillim, diferenca është te qytetarët. Pastaj a është në treg, a është në valixhe apo në jastëk, ajo është çështje tjetër.

Erjon Luçi –Regjistri është në Bankën e Shqipërisë, kështu që mund të kërkojmë informacion nëse është e nevojshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – A ka ndonjë pyetje apo diskutim tjetër?

Arben Pëllumbi - Duke pasur bindjen se me siguri do të gjendemi prapë këtu që ta rishtyjme këtë datë, unë mbështes propozimin e zotit Angjeli, që ta çojmë deri në vitin 2021 si datë, me tendencën që të jetë përfundimtare dhe ky lloj procesi të mbyllet. Nuk e di se çfarë mendon ministria për këtë?!

Erion Braçe – A keni ndonjë problem me shtyrjen e datës deri në vitin 2021?

Erjon Luçi – Jo, jemi dakord.

Erion Braçe – Atëherë kalojmë në votim

Hedhim në votim në parim projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.7918, datë 13.04.1995, “Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.1030, datë 23.02.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit (lekë privatizimi)” dhe dekretit nr.1049, datë 27.03.1995, “Për disa plotësime në dekretin nr.1030, datë 23.02.1995, “Për emetimin dhe shpërndarjen e bonove të privatizimit””, të ndryshuar””.

Kush është kundër? Pro? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1, me ndryshimin që propozoi zoti Angjeli, që afati të shkojë deri më datën 31.12.2021.

Kush është kundër? Pro? Abstenim? nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet.

Hedhim projektligjin në votim në tërësi. Kush është kundër? Pro? Abstenim?

Miratohet.

Zoti Zëvendësministër, faleminderit!

Nesër dhe pasnesër komisioni do të ketë dy ditë mbledhje, do të zhvillohet seancë dëgjimore me kandidatët e propozuar nga Këshilli i Ministrave për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik. Nesër do të jenë 13 anëtarët e parë dhe në ditën tjetër 10 anëtarët e tjerë.

Dua që të shfrytëzoj këtë mundësi t'u kërkoj mediave që seanca nesër do të fillojë fiks në orën 10:00 dhe gjatë seancës dëgjimore nuk do të ketë lëvizje në komision.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA